



Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry



AGJENCIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

**RAPORTI I INDIKATORËVE BAZË TË PERFORMANCËS PËR
REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE NË KOSOVË PËR
PERIUDHËN:
PRILL-QERSHOR 2019**

AGJENCIA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE TË KOSOVËS

KORRIK 2019

PËRMBAJTJA

I. HYRJE.....	3
II. KOHËZGJATJA E REGJISTRIMIT TË SHOQËRIVE TREGTARE	4
III. KOHËZGJATJA E REGJISTRIMIT TË SHPK-VE	5
IV. KOHËZGJATJA PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS QENDRAVE TË REGJISTRIMIT	6
V. REGJISTRIMI DHE Ç'REGJISTRIMI SIPAS FORMËS LIGJORE TË SHOQËRIVE TREGTARE.....	7
VI. REGJISTRIMI I DEGËVE TË SHOQËRIVE TË HUAJA TREGTARE SIPAS SHTETIT TË ORIGJINËS	7
VII. NUMRI I SHOQËRIVE TREGTARE NË TË CILAT ËSHTË I PËRFSHIRË SË PAKU NJË PRONAR, ORTAK OSE AKSIONAR I HUAJ	8
VIII.REGJISTRIMI I SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS GJINISË	9
IX. PËRMBLEDHJE NGA ARBK PËR TREMUJORIN E DYTË TË VITIT 2019 (T2 PRILL-QERSHOR 2019).....	10
X. PËRMBLEDHJE NGA ARBK VITI 2000 - QERSHOR 2019.....	11

I. HYRJE

Ky raport paraqet rezultatet e indikatorëve të performancës lidhur me procesin e regjistrimit të shoqërive tregtare në Kosovë për tremujorin e dytë të vitit 2019, punuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (në tekstin e mëtejme “ARBK”) me përkrahjen e Programit të USAID për Qeverisjen Ekonomike në Kosovë.

Gjatë kësaj periudhe, një ekip i përbashkët i përbërë nga zyrtarë të ARBK-së dhe këshilltarë nga Programi i USAID për Qeverisjen Ekonomike në Kosovë kanë analizuar një sërë **indikatorësh**¹ të lidhur me performancën e ARBK-së:

- Kohëzgjatjen për regjistrimin e shoqërive tregtare në përgjithësi në Kosovë dhe për Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar në veçanti, si dhe sipas qendrave të regjistrimit;
- Numrin total të shoqërive tregtare të regjistruara sipas formës ligjore dhe numrin total të shoqërive tregtare të ç’rejistruara sipas formës ligjore të shoqërive tregtare;
- Numrin total të degëve të shoqërive të huaja tregtare të regjistruara sipas shtetit të origjinës;
- Numrin e pronarëve, ortakëve ose aksionarëve të huaj të përfshirë në shoqëritë tregtare të Kosovës sipas llojit të shoqërive tregtare;
- Përqindjen e bizneseve individuale sipas gjinisë; dhe
- Përqindjen e ortakëve ose aksionarëve sipas gjinisë në shoqëritë tregtare në Kosovë.

Ky raport analizon të dhënat e nxjerra nga regjistri i ARBK-së për shoqëritë tregtare që sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare² në Kosovë kërkohen të regjistrohen në ARBK. Sipas këtij ligji, ARBK regjistron pesë forma themelore të shoqërive tregtare: (1) Bizneset Individuale, (2) Ortakëritë e Përgjithshme, (3) Ortakëritë e Kufizuara, (4) Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuara dhe (5) Shoqëritë Aksionare. Përveç këtyre formave themelore në ARBK regjistrohen edhe (1) Degët e Shoqërive të Huaja Tregtare, (2) Zyrat e Përfaqësisë të Shoqërive të Huaja Tregtare, (3) Ndërmarrjet Publike sipas ligjit në fuqi për ndërmarrjet publike, (4) Ndërmarrjet Shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe (5) Çfarëdo subjekti tjetër që me ligj të veçantë kërkohet të regjistrohet në ARBK si p.sh. Kooperativat Bujqësore.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (T2 Prill-Qershor 2018), në këtë tremujor (T2 Prill-Qershor 2019) vërehet një ngritje e kohëzgjatjes së regjistrimit për të gjitha shoqëritë tregtare prej **33%**³.

Kufizimet e raportit: Për qëllime të këtij raporti, **kohëzgjatja** është llogaritur duke pas parasysh vetëm ditët e punës prej datës së aplikimit deri në aprovimin e aplikacionit për regjistrim. Ky raport nuk bën ndonjë supozim dhe nuk ofron shifra lidhur me shoqëritë tregtare që janë aktive dhe funksionojnë në Kosovë, mirëpo fokusohet kryesisht në matjen e efikasitetit të ARBK-së dhe qendrave komunale të regjistrimit në zhvillimin e procedurave të regjistrimit ose ç’regjistrimit të shoqërive tregtare. Për të marrë një pasqyrë më të qartë të numrit, madhësisë, dhe statusit funksional të shoqërive tregtare dhe subjekteve tjera ekonomike të angazhuara në veprimtari ekonomike në Kosovë, ekziston nevoja për një përpjekje më gjithëpërfshirëse duke përfshirë institucionet tjera qeveritare, në radhë të dytë Administratën Tatimore të Kosovës dhe Ministrinë e Administratës Publike.

¹ Me avancimin e mëtutjeshëm të procesit të regjistrimit të shoqërive tregtare, duke përfshirë edhe përpjekjet për funksionalizimin e regjistrimit të plotë elektronik, pritjet që numri i indikatorëve dhe cilësia e të dhënave të rriten dhe të pasqyrohen në raportet pasuese.


² Ligji Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16426>

³ Formula: $(Vlera\ e\ re\ (V2) - Vlera\ e\ vjetër\ (V1)) \div Vlera\ e\ vjetër\ (V1) \times 100\% = \text{Ndryshimi në përqindje}$

II. KOHËZGJATJA E REGJISTRIMIT TË SHOQËRIVE TREGTARE

Shoqëritë tregtare, siç përcaktohet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, kërkohen të regjistrohen në zyrën qendrore të ARBK-së në Prishtinë ose në njërin nga 29 qendrat komunale për regjistrimin e shoqërive tregtare nëpër Kosovë. Kjo pjesë e raportit paraqet kohëzgjatjen e regjistrimit të shoqërive tregtare duke llogaritur vlerën mesatare të diferencës së ditëve të punës që nga data aplikimit deri tek data e aprovimit. Kohëzgjatja e regjistrimit për të gjitha shoqëritë tregtare gjatë tremujorshit të dytë të vitit 2019 (T2 Prill-Qershor 2019) ishte **2.54 ditë**, ku vërehet një përkeqësim prej **33%** krahasuar me 1.91 ditë sa ishte në tremujorëshin e njëjtë të vitit të kaluar (T2 Prill-Qershor 2018).


Grafiku I: Kohëzgjatja mesatare për regjistrimin e të gjitha formave të shoqërive tregtare, Prill-Qershor 2019 (T2 2019) dhe krahasimi me Prill-Qershor 2018 (T2 2018):



III. KOHËZGJATJA E REGJISTRIMIT TË SHPK-VE


Kjo pjesë e raportit paraqet vetëm kohëzgjatjen e regjistrimit të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK). Kohëzgjatja mesatare e regjistrimit vetëm e SHPK-ve në të gjitha qendrat e regjistrimit përfshirë edhe qendrën kryesore në Prishtinë (**Grafiku 2**) gjatë tremujorshit të dytë të vitit 2019 (T2 Prill-Qershor 2019) ishte **3.04 ditë**, ku vërehet një përkeqësim prej **37%** krahasuar me 2.22 ditë sa ishte në tremujorëshin e njëjtë të vitit të kaluar (T2 Prill-Qershor 2018).

Grafiku 2: Kohëzgjatja mesatare vetëm për regjistrimin e SHPK-ve, Prill-Qershor 2019 (T2 2019) dhe krahasimi me Prill-Qershor 2018 (T2 2018):



Për më tepër, **Grafiku 3** tregon kohëzgjatjen për regjistrimin e SHPK-ve vetëm në qendrën e regjistrimit të ARBK-së në Prishtinë. Kohëzgjatja mesatare e regjistrimit vetëm e SHPK-ve në Prishtinë (**Grafiku 3**) gjatë tremujorshit të dytë të vitit 2019 (T2 Prill-Qershor 2019) ishte **3.04 ditë**, ku vërehet një përkeqësim prej **14%** krahasuar me 2.66 ditë sa ishte në tremujorëshin e njëjtë të vitit të kaluar (T2 Prill-Qershor 2018).

Grafiku 3: Kohëzgjatja mesatare për regjistrimin e SHPK-ve vetëm në qendrën e regjistrimit të ARBK-së në Prishtinë, Prill-Qershor 2019 (T2 2019) dhe krahasimi me Prill-Qershor 2018 (T2 2018):



IV. KOHËZGJATJA PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS QENDRAVE TË REGJISTRIMIT

Tabela I tregon kohëzgjatjen mesatare për regjistrimin e të gjitha formave të shoqërive tregtare të ndara në 29 qendrat komunale për regjistrim si dhe në zyrën qendrore të ARBK-së në Prishtinë. Ndarja sipas qendrave të regjistrimit në tabelën më poshtë është bazuar në supozimin se nëse një shoqëri tregtare e ka adresën e regjistrimit p.sh në qytetin e Gjilanit, atëherë e njëjta po ashtu edhe është regjistruar në qendrën e regjistrimit në Gjilan, edhe pse ekziston mundësia që ajo shoqëri tregtare të jetë regjistruar në qendrën kryesore të ARBK-së në Prishtinë. Kjo është për arsye se ARBK aktualisht ka një sistem unik të regjistrimit të shoqërive tregtare i cili përfshin të dhënat për shoqëritë tregtare të regjistruara në të gjithë territorin e Kosovës, por jo sipas qendrave të regjistrimit.

Tabela I: Kohëzgjatja për regjistrimin e shoqërive tregtare sipas Qendrave për Regjistrimin e Shoqërive Tregtare, Prill-Qershor 2019:

Qendra e Regjistrimit	Prill	Maj	Qershor	Mesatarja	Nr. i shoqërive tregtare
Deçan	2.44	4.06	8.20	4.25	32
Dragash	2.00	2.25	1.00	2.00	10
Ferizaj	2.31	3.66	1.93	2.74	191
Fushë Kosovë	2.46	2.82	3.05	2.81	112
Gjakovë	2.03	1.49	1.61	1.71	112
Gjilan	4.02	3.73	5.71	4.40	165
Glllogoc	1.50	2.05	1.67	1.74	58
Graçanicë	2.44	5.90	1.20	3.63	24
Hani i Elezit	2.00	2.50	3.50	2.71	7
Istog	2.87	3.94	2.92	3.23	57
Kaçanik	1.33	1.56	2.17	1.67	21
Kamenicë	1.85	1.43	1.47	1.60	35
Klinë	2.85	2.33	1.91	2.49	37
Lipjan	1.71	2.00	2.10	1.93	68
Malishevë	3.83	3.29	1.89	3.13	38
Mitrovicë	1.88	1.75	1.45	1.70	99
Mitrovicë Veriore	1.15	1.75	1.45	1.44	36
Novobërdë		1.00		1.00	2
Obiliq	1.57	2.06	1.31	1.71	38
Pejë	3.09	2.30	1.63	2.37	145
Podujevë	2.20	1.50	1.81	1.81	81
Prishtinë	2.86	3.27	2.36	2.90	751
Prizren	1.28	1.67	1.25	1.42	212
Rahovec	2.42	3.12	6.00	3.08	40
Shtërpcë	2.00	2.00	1.00	1.50	6
Shtime	3.78	2.29	1.77	2.47	36
Skenderaj	2.00	2.15	2.04	2.06	49
Suharekë	3.38	2.76	1.68	2.68	76
Viti	2.55	2.16	2.19	2.26	46
Vushtrri	2.28	1.57	2.28	1.99	85
Mesatarja	2.53	2.74	2.29	2.54	2,669

*Ngjyra e kuqe paraqet mesatare të madhe të ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

*Ngjyra e gjelbër paraqet mesatare të vogël të ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

V. REGJISTRIMI DHE Ç'REGJISTRIMI SIPAS FORMËS LIGJORE TË SHOQËRIVE TREGTARE

Tabela 2 më poshtë paraqet numrin e shoqërive tregtare të regjistruara si dhe numrin e shoqërive tregtare të ç'regjistruara sipas formës ligjore të shoqërive tregtare të definuara me ligj për muaj, nga muaji Prill deri në Qershor të vitit 2019. Forma ligjore me numrin më të madh të regjistruarve gjatë këtij tremujorëshi ka qenë Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, pasuar nga Biznesi Individual. Forma ligjore me numrin më të madh të shuarjeve për këtë periudhë ishte Biznesi Individual, pasuar nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar.

Tabela 2: Numri i shoqërive tregtare të regjistruara dhe ç'regjistruara sipas formës ligjore, Prill-Qershor 2019:

SHOQËRI TREGTARE	Muaji	Forma Ligjore					Lloji i Shoqërisë					Totali
		(1) Biznes Individual	(2) Ortakëri e Përgjithshme	(3) Ortakëri e Kufizuar,	(4) Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara	(5) Shoqëri Aksionare	(1) Degë e Shoqërive të Huaja Tregtare	(2) Zyrë e Përfaqësisë të Shoqërive të Huaja Tregtare	(3) Ndërmarrjet Publike	(4) Ndërmarrjet Shoqërore	(5) Kooperativa Bujqësore	
TË REGJISTRUARA	Prill	305	2	0	540	3	7	0	0	0	0	857
	Maj	450	2	0	568	2	5	1	0	0	1	1,029
	Qershor	394	0	0	381	0	6	2	0	0	0	783
	Totali	1,149	4	0	1,489	5	18	3	0	0	1	2,669
TË Ç'REGJISTRUARA	Prill	144	3	0	7	0	0	0	0	0	0	150
	Maj	159	1	0	14	0	0	0	0	0	0	174
	Qershor	104	2	0	14	0	0	0	0	0	0	120
	Totali	403	6	0	35	0	0	0	0	0	0	444

VI. REGJISTRIMI I DEGËVE TË SHOQËRIVE TË HUAJA TREGTARE SIPAS SHTETIT TË ORIGINËS

Në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, në ARBK dhe Qendrat Komunale të Regjistrimit bëhet regjistrimi edhe i degëve të shoqërive të huaja tregtare. **Tabela 3** më poshtë tregon numrin total të degëve të shoqërive të huaja tregtare të regjistruara në Kosovë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, për periudhën Prill-Qershor 2019.

Tabela 3: Degët e shoqërive të huaja tregtare të regjistruara në Kosovë sipas shtetit të origjinës, Prill-Qershor 2019:

Shteti i origjinës	Numri i degëve të shoqërive të huaja tregtare
Bullgaria	1
Gjermania	2
Maqedonia e Veriut	1
Shqipëria	6
Slovakia	1
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	2
Turqi	2
Zvicër	3
Totali	18

VII. NUMRI I SHOQËRIVE TREGTARE NË TË CILAT ËSHTË I PËRFSHIRË SË PAKU NJË PRONAR, ORTAK OSE AKSIONAR I HUAJ

Për ta vlerësuar pjesëmarrjen e personave të huaj si pronarë, ortakë ose aksionarë në shoqëri tregtare në Kosovë janë paraqitur të dhënat në **Tabelën 4**, të cilat tregojnë numrin e shoqërive tregtare në të cilat është i përfshirë së paku një pronar, ortak ose aksionar i huaj, mirëpo kjo nuk tregon kapitalin e investuar nga personat e huaj. Gjatë periudhës Prill-Qershor 2019 janë regjistruar gjithsej 2,669 shoqëri tregtare nga të cilat 188 kanë të paktën një person të huaj fizik ose juridik si pronar, ortak ose aksionar, ku shihet se shumica janë SHPK-kë pasuar nga bizneset individuale. Nga kjo tabelë janë përjashtuar degët e shoqërive të huaja tregtare pasi që ato janë të paraqitura më lartë në **Tabelën 3**.


Tabela 4: Numri i të gjitha shoqërive tregtare (përjashtuar degëve) në të cilat është i përfshirë së paku një pronar, ortak ose aksionar i huaj, Prill-Qershor 2019 (T2 2019):

SHOQËRI TREGTARE	Muaji	(6) Biznes Individual	(7) Ortakëri e Përgjithshme	(8) Ortakëri e Kufizuara,	(9) Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara	(10) Shoqëri Aksionare	(6) Degë e Shoqërive të Huaja Tregtare	(7) Zyrë e Përfqësisë të Shoqërive të Huaja Tregtare	(8) Ndërmarrjet Publike	(9) Ndërmarrjet Shoqërore	(10) Kooperativa Bujqësore	Totali
TË REGJISTRUARA	Prill	7			62	1						70
	Maj	9			70	2		1				82
	Qershor	5			29			2				36
	Totali	21			161	3						188


VIII. REGJISTRIMI I SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS GJINISË

Të dhënat në **Grafikun 4 dhe 5** paraqesin pjesëmarrje sipas gjinisë në shoqëritë tregtare të regjistruara gjatë periudhës Prill-Qershor 2019. Për shkak të natyrës së formave të ndryshme ligjore të shoqërive tregtare, të dhënat më poshtë paraqiten ndaras për Bizneset Individuale, të cilat kanë pronar të vetëm dhe janë zakonisht biznese të vogla, dhe ndaras për format ligjore të tjera të shoqërive tregtare ku pronarët marrin pjesë si ortakë apo aksionarë në shoqëri tregtare më të mëdha ose më diverse.

Grafiku 4: Përqindja e Bizneseve Individuale sipas Gjinisë, Prill-Qershor 2019 (T2 2019):



Grafiku 5: Përqindja e Ortakëve dhe Aksionarëve sipas Gjinisë, Prill-Qershor 2019 (T2 2019):



IX. PËRMBLEDHJE NGA ARBK PËR TREMUJORIN E DYTË TË VITIT 2019 (T2 PRILL-QERSHOR 2019)

2,669

Shoqëri Tregtare të **regjistruara**



444

Shoqëri Tregtare të **ç'regjistruara**



Kohëzgjatja



2.54 ditë
Kohëzgjatja mesatare për **regjistrimin e të gjitha formave** të shoqërisë tregtare

3.04 ditë
Kohëzgjatja mesatare vetëm për **regjistrimin SHPK-ve**

3.04 ditë
Kohëzgjatja mesatare për regjistrimin **SHPK-ve** vetëm në **Prishtinë**

X. PËRMBLEDHJE NGA ARBK VITI 2000 - QERSHOR 2019

183,774

Shoqëri Tregtare
të **regjistruara**



18,041

Shoqëri Tregtare
të **ç'regjistruara**

